



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MIRDITË

Agjencia Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes

NJËSIA E PROKURIMIT

Rrëshen, më 02 . 10 .2025

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje materiale ndertimi, per sherbimet publike , te Agjencise se Puneve Publike dhe Mirembajtjes, Bashkia Mirdite

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):44111200-3

Materiale ndertimi,

VLERA E FONDIT LIMIT: 2 082 660 (dy milion e tetedhjetë e dymije gjashtëqind e gjashtedhjetë lekë pa TVSH

financuar nga Buxheti i Agjencise se Puneve Publike dhe Mirembajtjes .

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Agjencia e Puneve Publike dhe Mirembajtjes** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 Në rastin kur operatorët ekonomik nuk kanë detyrim ligjor të liçensohen nga QKB duhet të paraqesin Ekstraktin Tregtar, ku në fushën e veprimtarisë të jetë i përfshirë edhe objekti që prokurohet.

2.1.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një certifikatë të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës, që vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë ISO 45001-2018. Çertifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/ mallrave/ shërbimeve që do të marr përsipër të realizoj sipas kontratës së bashkëpunimit.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;...2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.”

Gjithashtu në **nenin 44** “Kërkesat e cilësisë” të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” përcaktohet se, citojmë: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se:

Referuar ligjit nr.10 081, datë 23.02.2009 “Për liçencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” dhe vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.538, datë 26.05.2009 “Për liçencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” operatorët ekonomikë të cilët nuk kanë detyrimin ligjor të liçensohen nga QKB-ja, duhet të paraqesin Ekstraktin Tregtar, të cilët në fushën e veprimtarisë duhet të kenë të përfshirë objektin e prokurimit.

Autoriteti kontraktor gjykon se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësojnë kërkesat e standarteve në lidhje me garantimin e cilësisë së produkteve në mënyrë të qëndrueshme (ISO 45001-2018).

Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet profesionale si më lart duke qënë se këto kriteret janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Por edhe sepse mbi të gjitha ato i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje e deklaratimit të xhiros vjetore gjaate tre viteve (2022,2023, 2024) leshuar nga autoriteti perkates ku vlera e xhiros per te pakten nje nga vitet e periudhes se kerkuar duhet te jete jo me e vogel se 40 perqind e vleres se fondit limit te kontrates qe prokurohet

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve (2022,2023,2024) të paraqitur në autoritetet perkatese, dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky autoritet,ku të pakten në dy bilance të njepasnjeshme, nuk ka raport negativ ndermjet aktivitet dhe pasivit

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimet që dëshmojnë se operatori ekonomik **ka paguar detyrimet përkatëse**, për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2024, sipas ligjit 9632/2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar.

Mbeshtetur në faktin që në formularin përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës perkatese të dst, ofertuesit vetedeklarojnë, ndër të tjera që operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqisë ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-se, operatorët duhet të paraqesin në fazën e ofertimit, të dokumentit që vërteton se operatori ekonomik pjesëmarrës, i ka plotësuar të gjitha detyrimet taksave dhe tarifave vendore për vitin 2020.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 1/b dhe 3** të ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik¹" në të cilët përcaktohet se, citojmë: "1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:b) gjendjen ekonomike dhe financiare;...3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci të tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitet dhe pasivit.Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës... Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër."

Në **nenin 43** “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko - financiare” të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare..”

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

5. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kurpërmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se:

Referuar ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar) neni 29 i tij, ligjit nr. 10 091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar) neni 41 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.922, datë 29.12.2014 “Për deklarin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike” dhe Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar) pika 3.12 e tij, autoriteti kontraktor gjykon që të kërkojë xhiron vjetore mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër dhe pasqyrat financiare për tre vitet e fundit (2021, 2022, 2023) pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin që të dorëzojnë në administratën tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës bilancin kontabël së bashku me anekset e tij, si dhe Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

Po, ashtu njësia e prokurimit gjykon se bazuar në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar), si dhe faktit ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lartë duke qënë se këto kriteret janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe se i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të procedurës .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 4** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.”

Në **nenin 40** “Kërkesat të veçanta për kontratat e mallrave” **pika 4** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.

Në **nenin 55** “Procedurë e hapur e thjeshtuar” **pika 4/b** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: 4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: **b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllëgaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i kësaj norme juridike vlerëson se edhe këto kritere janë të detyrueshme për t’u vendosur në DST. Fjala “**kërkon**” nënkupton se këto kriteret janë kritere detyrues, dhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërm.

Njësia përcaktoj kriteret për furnizime të ngjashme si më lart duke qënë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës.

Sipas këtij neni, Njësia vlerëson se duhen kërkuar dokumentacioni ligjor sipas parashikimit të pikës 4/b të nenit 55 që provon kryerjen e furnizimeve të ngjashme.

2.3.2

Operatori ekonomik duhet të paraqesë: - Autorizim nga prodhuesi ose distributor i autorizuar nga prodhuesi për mallrat e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor .

Ne rast se do të paraqitet kjo e fundit duhet të vertetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit.

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plotatë prodhuesit: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Njësia përcaktoj kriterin e mesipërm duke qënë se këto kritere garantojnë cilësinë e mallrave e garantuar kjo me dëshmitë perkatese . Këto kritere janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës.

8. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë në sistemin elektronik certifikatat ISO 45001-2018 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, e vlefshme leshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim dhe certifikatë cilësie për produktet e kërkuara. Certifikata kërkohej të jete e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. (Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave që ka marrë për sipër në kontratën e bashkëpunimit.).

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:**c) aftësinë teknike dhe profesionale.**

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në **nenin 40** “Kërkesat të veçanta për kontratat e mallrave” **pika 5, 6 dhe 8** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: **a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose... c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.**”

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: ... **c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.**

8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i normave juridike vlerëson se edhe këto kriteret janë të detyrueshme për t'u vendosur në DST. Fjala “**kërkon**” nënkupton se këto kriteret janë kriteret detyrues edhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërme.

9. Operatori Ekonomik duhet të deklarojë se merr për sipër furnizimin e mallit të kërkuar në objekt, pranë Autoritetit kontraktor, Brenda afateve të cilat do të përcaktohen gjatë ekzekutimit të kontrates sasitë dhe specifikimeve të përcaktuara.

**Njësia përcaktoj kriterin e mesipermduke qënë se eshte marreveshje kuader dhe per te garantua realizimin ne kohe dhe me cilesi te furnizimeve te mesiperme
Keto kritere janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës.**

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Bazuar në shkresën e ardhur nga grupi i punës i ngritur me nr prot 107 datë: 07.06.2021“Për përllogaritjrn e fondit limit”, ku bashkëlidhur kanë sjellë në sektorin e prokurimeve, specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi. Specifikimet teknike të dërguara, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin36 të ligjit **nr.162/2020, datë 23.12.2020** “Për Prokurimin publik”, dhe nenin40 pika 2 të Vendimin e Këshillit të Ministrave **Nr. 285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, njësia e prokurimit kreu miratimin e specifikimeve teknike për mallrat objekt prokurimi.

- Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.
- Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.

NJËSIA E PROKURIMIT

Alfred Shtinja

Estela Reçi

Tonin Gjonaj